KËRKESË
Nr.715, datë 10.2.2014

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i "Furnizimit me ujë i plazheve Durrës-Kavajë (nga pusshpimet e Çermës, degëzimi në Kavajë deri në depon e re Arapaj", loti III).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjellës Kanalizimeve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.138, datë 23.3.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit për pasuritë pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik".

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruar me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).

Vlera totale e tokës bujqësore, me sipërfaqe 5481.5 m^2, është 1 858 228.5 (një milion e tetëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e dyqind e njëzet e tetë pikë pesë) lekë.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto

LISTA E PRONARËVE DHE MASA E SHPËRBLIMIT
PËR SECILIN PRONAR SIPAS DOKUMENTEVE TË DORËZUARA NË DPUK

Nr.	**Emri, mbiemri**	**Zona kadastrale**	**Nr. i pasurisë**	**Arë (m^2)**	**Çmimi (lekë)**	**Vlefta (lekë)**
1	Sabri Kacmoli	1031	119/11	3700.9	339	1,254,605.10
2	Ramazan Kacmoli	1031	119/14	1780.6	339	603,623.4
				5481.5		1,858,228.5
Shuma (lekë)						**1,858,228.5**